



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



**Rregulla për vendosjen e të hyrave dhe çmimeve për Furnizuesin e Shërbimit
Universal
(Rregulla për Çmimet e FSHU)**

10 mars 2017

PËRMBAJTJA

KREU I	KUSHTET E PËRGJITHSHME	1
	Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi	1
	Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimet	1
KREU II	E DREJTA PËR SHËRBIM UNIVERSAL	4
	Neni 3 Shërbimi universal	4
	Neni 4 Përcaktimi i çmimit të arsyeshëm	4
	Neni 5 Vlerësimi i konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë	6
KREU III	OBLIGIMI I SHËRBIMIT PUBLIK UNIVERSAL	6
	Neni 6 Vendosija e obligimit të shërbimit publik	6
	Neni 8 Rregullimi i çmimeve për FSHU	7
KREU IV	TARIFA E SHITJES ME PAKICË PËR KONSUMATORËT E SHËRBIMIT UNIVERSAL	7
	Neni 9 Parimet e përgjithshme	7
	Neni 10 Shqyrtimet e vlerave hyrëse	8
	Neni 11 Përshtatjet e të hyrave të rregulluara	8
	Neni 12 Shqyrtimet e jashtëzakonshme	9
KREU V	VLERAT HYRËSE	9
	Neni 13 Përkufizimi i vlerave hyrëse	9
	Neni 14 Specifikimi i vlerave hyrëse	10
KREU VI	TË HYRAT E RREGULLUARA TË SHËRBIMIT UNIVERSAL	10
	Neni 15 Parimet e përgjithshme	10
	Neni 16 Kostot e lejuara me pakicë	11
	Neni 17 Kostot e lejuara të kapitalit punues	12
	Neni 18 Kostot e lejuara të borxhit të keq	12
	Neni 19 Kostot e blerjes së energjisë me shumicë	13
	Neni 20 Kostot që barten	14
	Neni 21 Alokimi i kostove	15
KREU VII	METODOLOGJIA PËR STRUKTURËN TARIFORE	15
	Neni 22 Metodologjia për strukturimin e tarifës me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal	15
KREU VIII	DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	17
	Neni 23 Gjuha zyrtare e Rregullës	17
	Neni 24 Ndryshimi	17
	Neni 25 Interpretimi	17
	Neni 26 Shfuqizimi	17
	Neni 27 Hyrja në fuqi	17
SHTOJCA 1	LLOGARITJA E TË HYRAVE TË RREGULLUARA TË SHËRBIMIT UNIVERSAL	18
SHTOJCA 2	PROCESI I SHQYRTIMIT TË VLERAVE HYRËSE	21
SHTOJCA 3	PROCESI I PËRSHTATJEVE VJETORE	24



SHTOJCA 4	PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM	26
SHTOJCA 5	NGJARJET E JASHTËZAKONSHME	29
SHTOJCA 6	NGJARJET E FORCËS MADHORE	30



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.16, Nenin 25 dhe Nenin 42, paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, në seancën e mbajtur me 30.09.2011, miratoi:

Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit të shërbimit universal (Rregulla për Çmimet e FSHU)

KREU I KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1 Kjo rregull përcakton:
 - 1.1 Metodologjinë për vendosjen e tarifës së shitjes me pakicë për konsumatorët e shërbimeve universale që marrin shërbimet nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) për shitjen me pakicë të energjisë elektrike; dhe
 - 1.2 Procesin për shqyrtimin dhe përshtatjen e tarifës së shitjes me pakicë për konsumatorët e shërbimeve universale dhe
 - 1.3 Se si Rregullatori mund të imponojë obligimin e shërbimit publik mbi furnizuesin e shërbimit universal për konsumatorëve të cilët gëzojnë të drejtën e furnizimit me shërbim universal.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

- 1 Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
 - 1.1 “Të hyra të rregulluara aktuale” nënkupton të hyrat që mbulohen nga FSHU, duke ua ngarkuar tarifën e shitjes me pakicës për konsumatorët e shërbimit universal konsumatorëve të rregulluar; të matur në baza rrjedhëse;
 - 1.2 “Përshtatje vjetore” nënkupton përshtatjet e të hyrave të lejuara dhe tarifës së rregulluar me pakicë, të realizuar në fund të çdo viti relevant;
 - 1.3 “Borxhi i keq i lejuar” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 16, paragrafi 1;



- 1.4 “Ditë pune” quhen të gjitha ditët e punës brenda një jave, të përcaktuara sipas ligjeve në Kosovë;
- 1.5 “Kategori e konsumatorëve” nënkupton klasifikimin e llojeve të ndryshme të konsumatorëve për qëllime të ngarkimit me tarifën me pakicë. Klasifikimi duhet të ketë parasysh mënyrën e matjes së energjisë aktive dhe kapacitetit, mënyrën e konsumit të energjisë elektrike, ngarkesën e pikut, tensionin e furnizimit dhe karakteristikat e tjera që kanë ndikim në koston e furnizimit;
- 1.6 “Operatori i sistemit të shpërndarjes” apo “OSSH” nënkupton bartësin e licencës për operator të sistemit të distribucionit;
- 1.7 “Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes” nënkupton tarifën e rregulluar të ngarkuar nga OSSH për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- 1.8 “Faktori ndarës i eksportit” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 17, paragrafi 7;
- 1.9 “EURIBOR” - norma e ofrimit për depozita të euros nga Federata bankare evropiane për periudhë 12-mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të “Reuters” në ora 11:00 (kohë e matur sipas kohës qendrore evropiane) ose, në rast se “Reuters” nuk vazhdon ta ofrojë këtë informacion, cilido shërbim tjetër për të cilin pajtohen OSD dhe Rregullatori. Për të shmangur dyshimin kjo do të jetë normë vjetore;
- 1.10 “Përshtatje e jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;
- 1.11 “Ngjarje e jashtëzakonshme” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6;
- 1.12 “Shqyrtim i jashtëzakonshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 12;
- 1.13 “Vendim final” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3, paragrafi 10
- 1.14 “Ngjarjet e forcës madhore” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 7;
- 1.15 “Vlerësimi i impaktit” – një vlerësim të nevojave për dhe nga një obligim i shërbimit universal i kryer në pajtim me nenin 6 të kësaj rregulle;
- 1.16 “Vlerat hyrëse” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 13;
- 1.17 “Shqyrtimi i vlerave hyrëse” nënkupton shqyrtimin nga rregullatori për të përcaktuar vlerat hyrëse;
- 1.18 “Taksa për licencë” nënkupton shumën për pagesë sipas Nenit 7 të pasqyrës së taksave, që lëshohet nga rregullatori dhe mund të amendamentohet;



- 1.19 “Operator i tregut” apo “OT” nënkupton bartësin e licencës për operator të tregut;
- 1.20 “Ngarkesat e operatorit të tregut” apo “Ngarkesat OT” nënkupton serinë e rregulluar të ngarkesave që aplikohen nga OT-ja për ofrimin e shërbimeve të operatorit të tregu
- 1.21 “Pragu i materialitetit” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5
- 1.22 “Vlera neto e tanishme” nënkupton shumën e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë
- 1.23 “Kostot që barten” nënkupton kostot e përcaktuara në pajtim me Nenin 20;
- 1.24 “Propozim” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3, paragrafi 5;
- 1.25 “Vlerësim i përkohshëm” ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 3, paragrafi 8
- 1.26 “Konsumator i shërbimit universal” nënkupton një konsumator që ka të drejtën e shërbimit universal sipas kuptimit të nenit 3.1.72 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
- 1.27 “Furnizuesi i shërbimit universal” nënkupton furnizuesin mbi të cilin është vendosur një obligim i shërbimit publik për të siguruar shërbim universal me kushte të rregulluara;
- 1.28 “Konsumatorët e rregulluar” kanë kuptimin që i jipet me nenin 1, paragraf 1;
- 1.29 “Vlerësim i konkurrencës në tregun me pakicë” – nënkupton një vlerësim të efektivitetit të konkurrencës së furnizimit me pakicë të tregut të kryer në pajtim me nenin 5 të kësaj rregulle;
- 1.30 “Tarifë e shitjes me pakicë për konsumatorët e shërbimeve universale” nënkupton bashkësinë e çmimeve që FSHU ua ngarkon konsumatorëve të rregulluar për ofrimin e shërbimeve standarde, siç përcaktohen nga rregullatori;
- 1.31 “Rregullatori” nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji;
- 1.32 “Vit relevant” nënkupton periudhën prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm në mes të përshtatjeve vjetore;
- 1.33 “Marzha me pakicë” e ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 13;
- 1.34 “Shërbime standarde” nënkupton shërbimet që u ofrohen konsumatorëve për furnizimin me energji elektrike nga FSHU, siç përkufizohen në Licencën për furnizim publik dhe kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
- 1.35 “Raport i ndikimit financiar” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 5;



- 1.36 “Ngarkesat e operatorit të sistemit” apo “Ngarkesat OS” nënkuptojnë ngarkesat e aplikuara nga OST për kryerjen e shërbimeve të operatorit të sistemit;
 - 1.37 “Periudhë kalimtare” e ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
 - 1.38 “Ngarkesë për shfrytëzimin e rrjetit të sistemit të transmisionit” apo “Ngarkesë TNUOS” nënkupton ngarkesën e rregulluar që aplikohet nga OST për transmetimin e energjisë elektrike
 - 1.39 “Operator i sistemit të transmisionit” apo “OST” nënkupton bartësin e Licencës së Operatorit të sistemit të transmisionit;
 - 1.40 “Konsumatorët e parregulluar” nënkupton çdo konsumator të FSHU-së që nuk është konsumator i rregulluar;
- 2 Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.

KREU II E DREJTA PËR SHËRBIM UNIVERSAL

Neni 3

Shërbimi universal

- 1 Të gjithë konsumatorët finalë shtëpiakë dhe jo-shtëpiakë me qarkullim vjetor prej më pak se dhjetë (10) milionë euro ose jo më shumë pesëdhjetë (50) punëtorë kanë të drejtën e shërbimit universal. Kolektivisht, këta konsumatorë referohen si “konsumatorët e shërbimit universal”
- 2 Një konsumator i shërbimit universal ka të drejtë të furnizohet me energji elektrike me kualitetit të arsyeshëm të përcaktuar, me çmime të arsyeshme, transparente dhe jo-diskriminuese.

Neni 4

Përcaktimi i çmimit të arsyeshëm

- 1 Çmimet e ngarkuara për konsumatorët e shërbimit universal do të konsiderohen të arsyeshme, nëse ato përfaqësojnë çmimin që një furnizues në një treg efektivisht konkurrent furnizon me pakicë energjinë elektrike pritet të aplikojë.
- 2 Me qëllim të përcaktimit nëse çmimet e ngarkuara për konsumatorët e shërbimit universal konsiderohen të jenë të arsyeshme, Rregullatori do të vlerësojë nivelin e konkurrencës në



furnizimin me pakicë të konsumatorëve të shërbimit universal në përputhje me nenin 5 më poshtë.

- 3 Kur tregu me pakicë i furnizimit për konsumatorët e shërbimit universal vlerësohet si jo konkurrent, Rregullatori do të vlerësojë më tej nëse në mungesë të rregullimit të çmimit, çmimet e ngarkuara për konsumatorët e shërbimit universal janë të pa-arsyeshme.
- 4 Me qëllime që të demonstrohet se një çmim i ngarkuar për të gjitha ose për ndonjë klasë të konsumatorëve të shërbimit universal është i arsyeshëm, në përputhje me paragrafin 3 më sipër, furnizuesi i licencuar mund:
 - 4.1 Të demonstrojë se çmimi i ngarkuar për konsumatorët e shërbimit universal është i barabartë ose më i vogël se një çmim i rregulluar i miratuar nga Rregullatori në pajtim me këtë Rregull.
 - 4.2 Aty ku nuk ka çmim të rregulluar në fuqi për çdo klasë të konsumatorëve të shërbimit universal, të ofrojë informata bindëse për Rregullatorin se çmimi i ngarkuar për konsumatorët e shërbimit universal paraqet rezultatin e një prokurimi konkurrues të furnizimit me shumicë të energjisë elektrike, tarifat e rrjetit të rregulluar dhe një marzhë të përcatuar nga Rregullatori.
 - 4.3 Kostot e energjisë elektrike të blerë duhet të realizohen në mënyrë konkurruese.
- 5 Kur një konsumator i shërbimit universal zgjedh të furnizohet nga i licencuari për furnizim sipas kushteve të kontratës së furnizimit konkurrent:
 - 5.1 Termat dhe kushtet e furnizimit duhet të përcaktohen reciprokisht ndërmjet të licencuarit për furnizim dhe konsumatorit të shërbimit universal dhe nuk përfaqësojnë një ofertë për furnizim universal.
 - 5.2 Konsumatori i shërbimit universal ka të drejtën për t'u furnizuar nga furnizuesi i licencuar që ka obligim të shërbimit universal në përputhje me ofertën e shërbimit të furnizimit universal të atij furnizuesi për aq kohë sa që ai i plotëson kërkesat e nenit 3, paragrafi 1 më sipër.
 - 5.3 Një konsumator i shërbimit universal që kalon nga furnizuesi pa detyrim të shërbimit universal tek furnizuesi që ka një detyrim të tillë duhet të bëjë këtë në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.



Neni 5

Vlerësimi i konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë

- 1 Në baza vjetore, Rregulatori do të kryejë një vlerësim të efektivitetit të konkurrencës në tregun e energjisë elektrike me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal.
- 2 Vlerësimi i konkurrencës së tregut të shitjes me pakicë do të shfrytëzojë indikatorë të verifikueshëm dhe të matshëm të nivelit të konkurrencës në furnizimin me pakicë të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët e shërbimit universal dhe veç e veç për konsumatorët familjarë dhe për konsumatorët komercialë të cilët kanë të drejtën e shërbimit universal.
- 3 Vlerësimi i konkurrencës së tregut të shitjes me pakicë do të përfshijë:
 - 3.1 Një vlerësim të nivelit të konkurrencës në tregun e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e shërbimit universal;
 - 3.2 Vlerësimin e Rregulatorit nëse konkurrenca konsiderohet efektive apo jo;
 - 3.3 Vlerësimin e Rregulatorit nëse konkurrenca joefektive kërkon rregullimin e çmimeve për të siguruar që konsumatorët e shërbimit universal të furnizohen me një çmim të arsyeshëm, varësisht nga vlerësimi i ndikimit rregullator i nevojshëm nëse duhet vendosur një obligim të shërbimit universal.
 - 3.4 Një plan veprimi kohor për heqjen e rregullimit të tillë të çmimeve, në pajtim me nenin 38 të Ligjit për Energjinë Elektrike 05 / L-085. Ky plan veprimi do të përditësohet çdo vit.

KREU III OBLIGIMI I SHËRBIMIT PUBLIK UNIVERSAL

Neni 6

Vendosja e obligimit të shërbimit publik

- 1 Për të siguruar ofrimin e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, Rregulatori mund të ngarkojë me obligime të shërbimit publik cilindo furnizues, duke obliguar atë që të ofrojë furnizim me energji elektrike konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal.



- 2 Obligimi i shërbimit universal duhet të vendoset mbi furnizuesin e shërbimit universal si një obligim i shërbimit publik dhe do të rishikohet të paktën çdo tre vjet ose një periudhë më të shkurtër sipas vlerësimit të Rregullatorit.
- 3 Para ri-vendosjes së një obligimi të shërbimit universal, Rregullatori do të kryejë një vlerësim të kushteve të furnizimit në përputhje me kërkesat e nenit 5 të Ligjit për Energjinë Elektrike 05 / L-085.

Neni 8

Rregullimi i çmimeve për FSHU

- 1 Pas vlerësimit të konkurrencës e tregut me pakicë të kryer çdo vit në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulle, Rregullatori mund të përcaktojë se çmimet për disa ose të gjithë konsumatorët e shërbimit universal duhet të rregullohen për të siguruar që ato të jenë të arsyeshme.
- 2 Kur Rregullatori bën një përcaktim të tillë, furnizuesi i shërbimit universal do të përgatis dhe dorëzojë te Rregullatori çmimet e propozuara për furnizim për konsumatorët e shërbimit universal.
- 3 Këto propozime do të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Rregull dhe do të përfshijnë provat e nevojshme për të mbështetur tarifat e propozuara.
- 4 Furnizuesi i Shërbimit Universal do të mbajë llogari të ndara kontabël në mes të aktiviteteve të rregulluara të Furnizimit të Shërbimit Universal dhe aktiviteteve të tjera komerciale.

KREU IV TARIFA E SHITJES ME PAKICË PËR KONSUMATORËT E SHËRBIMIT UNIVERSAL

Neni 9

Parimet e përgjithshme

- 1 FSHU i ngarkon konsumatorët e rregulluar me tarifën me pakicë për shërbimin universal të miratuar nga Rregullatori.
- 2 Tarifa me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal përcaktohet dhe miratohet gjatë çdo viti relevant, ashtu që:
 - 2.1 Të hyrat që FSHU parashikon të mbledhë nga tarifa me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal do të mbulojnë të gjitha kostot për ofrimin e shërbimit universal (Kreu V); dhe
 - 2.2 Tarifa me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në metodologjinë e strukturës tarifore (Kreu VII).



- 3 Të hyrat e rregulluara FSHU përcaktohen si vijon:
 - 3.1 Të hyrat e rregulluara të shërbimit universal përcaktohen gjatw cdo viti relevant;
 - 3.2 Prpopozimi pwr tw hyrat e rregulluara do tw dorwzohet nga FSHU tek Rregullatori pwr aprovim para cdo viti relevant;
 - 3.3 Llogaritja e të hyrave të rregulluara të shërbimit universal përdor vlerat hyrëse të caktuara gjatë shqyrtimeve të vlerave hyrëse; dhe
 - 3.4 Shqyrtimet e jashtëzakonshme, që përfshijnë përshtatjen e të hyrave të rregulluara të shërbimit universal për ndryshimet materiale në kosto apo në të hyra e që shkaktohet nga një ngjarje e jashtëzakonshme, do të realizohen kur është e nevojshme.

Neni 10

Shqyrtimet e vlerave hyrëse

- 1 Vlerat hyrëse të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të rregulluara të shërbimit universal të FSHU-së do të caktohen gjatë shqyrtimeve të vlerave hyrëse. Ndryshimet në vlerat hyrëse duhet të bëhen vetëm në atë masë që këto ndryshime të jenë të arsyeshme, të justifikuara dhe të caktuara me kujdes.
- 2 Shqyrtimet e vlerave hyrëse do të iniciohen nga Rregullatori kurdo që rrethanat e ndryshuara kërkojnë inicimin e një shqyrtimi të tillë.
- 3 FSHU mund t'i propozojë Rregullatorit fillimin e shqyrtimit të vlerave hyrëse. Rregullatori do t'i përgjigjet kërkesës së tillë me një shkresë që paraqet arsyetimet për vendimin e tij për të filluar apo për të mos filluar shqyrtimin.
- 4 Procedura për mbarëvajtjen e shqyrtimeve të vlerave hyrëse është dhënë në Shtojcën 3.

Neni 11

Përshtatjet e të hyrave të rregulluara

- 1 Ndryshimi në të hyrat e rregulluara të shërbimit universal që mund të rezultojë si pasojë e ndryshimit në mes të të hyrave të lejuara dhe kostove të realizuara do të përcaktohet gjatë përshtatjeve vjetore.



- 2 Përshtatjet vjetore do të bëhen para çdo viti relevant sipas procesit të përshkruar në Shtojcën 4.
- 3 Përshtatjet për të Hyrat e Rregulluara të FSHU-së do të marrin parasysh ndryshimet në mes të të hyrave të realizuara dhe të kostove të realizuara për ato kategori e shpenzimeve që varen në mënyrë direkte nga niveli i furnizimit.
- 4 Formulatat për llogaritjen e të hyrat e rregulluara të shërbimit universal gjatë azhurnimeve vjetore janë dhënë në Shtojcën 1.

Neni 12

Shqyrtimet e jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga ngjarjet e jashtëzakonshme, siç përkufizohen në Shtojcën 6.
- 2 Gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e rregulluara të shërbimit universal për pjesën e mbetur të periudhës rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të bëhet përshtatja në të hyrat e rregulluara të shërbimit universal. Pragu i materialitetit do të jetë 5% e të hyrave, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshje të përbashkët në mes të FSHU-së dhe Rregullatorit.
- 3 Llogaritja e ndikimit mbi të hyrat e rregulluara të shërbimit universal dhe përshtatja e të hyrave nuk duhet të marrë parasysh faktorët të cilët nuk ndikohen në mënyrë direkte nga ngjarja e jashtëzakonshme.
- 4 Rregullatori do të marrë parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë praguin e materialitetit) në përshtatjet vjetore të ardhshme.
- 5 Procesi për realizimin e shqyrtimeve të jashtëzakonshme jepet në Shtojcën 5.

KREU V

VLERAT HYRËSE

Neni 13

Përkufizimi i vlerave hyrëse

- 1 Vlerat hyrëse janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrat e rregulluara të shërbimit universal të FSHU-së.



- 2 Vlerat hyrëse përbëhen nga:
 - 2.1 Jetëgjatësia ekonomike e asetëve të lidhura me FSHU;
 - 2.2 Marzha me pakicë;
 - 2.3 Niveli i lejuar për borxhet e këqija;
 - 2.4 Faktori ndarës balancues; dhe
 - 2.5 Faktori ndarës i eksportit.

Neni 14

Specifikimi i vlerave hyrëse

- 1 Vlerat pasuese specifikohen si vlera fikse, të cilat do të aplikohen gjatë viteve relevante deri në shqyrtimin e vlerave hyrëse:
 - 1.1 Jetëgjatësia ekonomike e asetëve;
- 2 Vlerat pasuese mund të specifikohen si fikse apo si tabelë vlerash me ç'rast do të aplikohet vlerë e ndryshme për çdo vit relevant nga viti i tanishëm relevant deri në shqyrtimin e ardhshëm të vlerave hyrëse:
 - 2.1 Marzha me pakicë;
 - 2.2 Niveli i lejuar për borxhet e këqija; dhe,
 - 2.3 Faktori ndarës i debalancit.

KREU VI TË HYRAT E RREGULLUARA TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

Neni 15

Parimet e përgjithshme

- 1 Të hyrat e rregulluara të shërbimit universal do të jenë të barabarta me kostot e arsyeshme të FSHU-së për ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar, për aq sa këto kosto do të jenë të arsyeshme dhe të matura saktësisht.
- 2 Kostot e arsyeshme të FSHU-së do të përfshijnë:



- 2.1 Kostot e lejuara me pakicë (Neni 16);
 - 2.2 Kostot e lejuara të kapitalit punues (Neni 17);
 - 2.3 Kostot e lejuara të borxhit të keq (Neni 18);
 - 2.4 Kostot e lejuara të energjisë elektrike me shumicë (Neni 19), duke përfshirë marzhën me pakicë, të cilat duhet të barten bazuar në faktorin ndarës të debalancit dhe faktorin ndarës të eksportit gjatë azhurnimeve vjetore;
 - 2.5 Kostot e bartura të cilat përfshijnë ngarkesat e OT-së, OS-së, TNUOS, DUOS dhe taksat për licenca, të cilat barten plotësisht, gjatë azhurnimeve vjetore.
- 3 Gjatë përcaktimit të kostove të lejuara, rregullatori do t'u referohet, por nuk kufizohet në:
- 3.1 Informatat ekzistuese të periudhave të kaluara për vëllimin, koston dhe kualitetin e shërbimeve të FSHU-së;
 - 3.2 Parashikimin rreth vëllimit, kostove dhe kualitetit të shërbimeve të FSHU-së;
 - 3.3 Krahasimet me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës; dhe
 - 3.4 Krahasimet me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës.
- 4 Kostot rezultuese të arsyeshme do t'u alokohen konsumatorëve të rregulluar siç parasheh Neni 21.
- 5 Çdo e hyrë tjetër, që nuk është mbledhur nga tarifat, por që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar, do të zbritet nga të hyrat e rregulluara të shërbimit universal, duke përfshirë çfarëdo ndryshimi në mes të vlerës së shitjeve të aseteve dhe vlerës së tyre rregullative.

Neni 16

Kostot e lejuara me pakicë

- 1 Kostot e lejuara me pakicë përfshijnë këto kosto të lejuara që kanë të bëjnë me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar:
 - 1.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes;
 - 1.2 Kostot e korporatës;



- 1.3 Kostot e zhvlerësimit; dhe
 - 1.4 Çdo kosto tjetër me të cilën në mënyrë të arsyeshme është ballafaquar FSHU-ja gjatë ofrimit të shërbimeve me pakicë për konsumatorët e rregulluar.
- 2 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes nuk do të përfshijnë kostot e reklamimit dhe formave të tjera të marketingut që kanë për qëllim inkurajimin e konsumit, për arsye se FSHU-ja nuk konkurren për konsumatorët e rregulluar; dhe tatimet apo detyrimet që synohet të mblidhen përmes marzhës me pakicë.
 - 3 Kostot e lejuara të korporatës përfshijnë kostot (ose një pjesë të kostos totale të korporatës nëse FSHU-ja është kompani vartëse apo kompani degë e ndonjë entiteti tjetër) që janë të nevojshme dhe i atribuohen funksionimit të rregullt të FSHU-së por që, duke përdorur praktika normale dhe të zakonshme të kontabilitetit, nuk lidhen drejtpërsëdrejti me ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar.
 - 4 Komunikimet publike për informata rreth sigurisë, konservimit, inkurajimit të pagesave të rregullta dhe dekurajimit të shfrytëzimit të paautorizuar janë kosto të lejueshme.

Neni 17

Kostot e lejuara të kapitalit punues

- 1 Kostot e kapitalit punues do të llogariten si kostoja e financimit të kapitalit punues për FSHU-në, shumëzuar me vlerën e lejuar të kapitalit punues.
- 2 Kostoja e financimit të kapitalit punues do të llogaritet si EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga Rregullatori gjatë përshtatjeve vjetore dhe reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra.
- 3 Vlera e lejuar e kapitalit punues do të llogaritet si 1/12-ta e shumës së kostove të lejuara me pakicë, kostot e lejuara të energjisë me shumicë, kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë dhe kostot që barten.

Neni 18

Kostot e lejuara të borxhit të keq

- 1 Kostot e lejuara të borxhit të keq do të llogariten duke aplikuar nivelin e lejuar të borxhit të keq sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1.
- 2 Niveli i lejuar i borxhit të keq do të jetë një vlerësim i përafërt i nivelit të arsyeshëm të borxheve të këqija që mund ta ketë FSHU-ja.



Neni 19

Kostot e blerjes sw energjisë me shumicë

- 1 Furnizuesi i Shwrbimit Universal është i detyruar të sigurojë energji elektrike nw mënyrë transparente, ekonomike dhe efikase.
- 2 Furnizuesi i Shwrbimit Universal duhet të demonstrojë se çmimet e parashikuara të energjisë elektrike që do të prokurohen janë të arsyeshme. Kjo mund të përfshijë, por nuk kufizohet, nw demonstrimin se:
 - 2.1 Çmimet e parashikuara janë në përputhje me çmimet historike dhe ato të projektuara të tregut me shumicë të Kosovës.
 - 2.2 Çmimet e parashikuara janë në përputhje me çmimet historike dhe të projektuara të tregut me shumicë të rajonit.
 - 2.3 Çmimet e projektuara rezultojnë nga një prokurim konkurrues i furnizimeve me shumicë të energjisë elektrike.
 - 2.4 Çmimet e projektuara janë në përputhje me tarifat e rregulluara të aplikuara për blerjet ku këto janë rezultat i një obligimit të imponuar për të licencuarit. Furnizuesi SHU duhet të ofrojë të gjithë energjinë dhe kapacitetit për konsumatorët e privilegjuar për shërbimin universal të furnizimit.
- 3 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë që kanë të bëjnë me shërbimin për konsumatorët e rregulluar përfshijnë:
 - 3.1 Kostot e blerjes së energjisë nga gjenerimi vendor;
 - 3.2 Kostot e importit të energjisë;
 - 3.3 Marzhën me pakicë në shpenzimet e energjisë së prokuruar për të siguruar shërbimet universale;
 - 3.4 Kostot neto të debalancit, që i nënshtrohen faktorit ndarës të debalancit.
- 4 Kostot e lejuara neto të debalancit do të përfshijnë kostot e realizuara minus të hyrat e fituara (siç përcaktohen në pajtueshmëri me rregullat e tregut) që rezultojnë nga debalancet në mes të kërkesës së realizuar nga konsumatorët e rregulluar dhe furnizimi i kontraktuar me energji.
- 5 Faktori ndarës i debalancit duhet të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot neto të debalancit për të përcaktuar ndarjen e këtyre shpenzimeve në mes të FSHU-së dhe Konsumatorëve të rregulluar, ku vlera prej 0% nënkupton që të gjitha kostot neto të debalancit i alokohen FSHU-së, ndërsa vlera prej 100% nënkupton që të gjitha kostot neto të



debalancit u alokohen konsumatorëve. Gjatë përcaktimit të Faktorit ndarës të debalancit, rregullatori duhet të marrë parasysh se deri në ç'masë është në gjendje FSHU-ja që të menaxhojë debalancet dhe, në veçanti, balancin në mes të furnizimeve nga prodhimi vendor dhe importet e qëndrueshme si dhe kërkesës së përmbushur nga FSHU-ja.

- 6 Verifikimi i kostove me shumicë të energjisë për të siguruar shërbimin e furnizimit universal do të kryhet në përputhje me parimet e përcaktuara në Shtojcën 2.
- 7 Marzha me pakicë do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e lejuara të energjisë me shumicë dhe kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë. Ajo duhet të caktohet në atë nivel që:
 - 7.1 T'i sigurojë FSHU-së përfitim të arsyeshëm që ta kompensojë për rreziqet që ndërmerr gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar marzhave të fituara nga kompanitë e ngjashme në vende të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato vende dhe atë të Kosovës; dhe
 - 7.2 T'i sigurojë FSHU-së kthim të arsyeshëm nga asetet fikse neto të saj të përdorura gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar kostos së kapitalit të të licencuarve të tjerë në Kosovë.

Neni 20

Kostot që barten

- 1 FSHU-ja duhet t'i bartë të gjitha kostot që barten gjatë secilës përshtatje vjetore, që do të përfshijë:
 - 1.1 Kostot e OT-së që faturohen nga OT dhe kanë të bëjnë me konsumatorët e shërbimit universal;
 - 1.2 Kostot e OS-së që faturohen nga OST dhe kanë të bëjnë me konsumatorët e shërbimit universal;
 - 1.3 Kostot SHST që faturohen nga OST dhe kanë të bëjnë me konsumatorët e shërbimit universal;
 - 1.4 Kostot DUOS që faturohen nga OSSH dhe kanë të bëjnë konsumatorët e shërbimit universal; dhe
 - 1.5 Pjesën e taksës së licencës që u përket konsumatorëve të shërbimit universal.



Neni 21

Alokimi i kostove

- 1 Kostot e arsyeshme të llogaritura sipas këtij kapitulli do të alokohen si më poshtë:
 - 1.1 Kostot e lejuara me pakicë dhe kostot e lejuara të kapitalit punues do të alokohen në proporcion me numrin e konsumatorëve. Për ta bërë këtë, kostoja mesatare për konsumator duhet të llogaritet duke pjesëtuar shumën e kostove totale me pakicë të konsumatorëve të rregulluar të vlerësuar sipas kostove të ndryshme për ofrimin e shërbimit me pakicë për grupet e ndryshme të konsumatorëve të rregulluar. Kjo kosto mesatare për konsumator do të shumëzohet me numrin e konsumatorëve të rregulluar për të përcaktuar kostot e lejuara me pakicë, dhe kostot e kapitalit punues që duhen të mbulohen prej konsumatorëve të rregulluar.
 - 1.2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë do t'u alokohen konsumatorëve të rregulluar në një mënyrë që nuk e çorienton konkurrencën për konsumatorët e parregulluar.
 - 1.3 Kostot që barten duhet t'u alokohen konsumatorëve të rregulluar në një mënyrë që ruan, aq sa është e mundur, sinjalin e çmimeve të ngarkesave.

KREU VII METODOLOGJIA PËR STRUKTURËN TARIFORE

Neni 22

Metodologjia për strukturimin e tarifës me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal

- 1 Struktura e tarifës me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal do të jetë në përputhje me metodologjinë e caktuar në këtë nen dhe me udhëzimet e tjera që mund të nxirren nga Rregullatori.
- 2 Një bashkësi e vetme e çmimeve do të aplikohet për cilindo kategori të konsumatorëve.
- 3 Tarifa me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal nuk do të ketë ndër-subvencionim në mes të kategorive të konsumatorëve.
- 4 Tarifa me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal do të marrë parasysh çështjet mjedisore.
- 5 Tarifat në blloqe mund të përdoren për të nxitur konsumin eficient të energjisë elektrike. Njëkohësisht, këto tarifa mund të përdoren për raste sociale kur rregullatori mbi bazë të dëshmive në dispozicion nuk është i kënaqur me nivelin e mbulueshmërisë së konsumatorëve në nevojë nga mekanizmat e tjerë subvencionues.



- 6 Tarifa me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal do të përfshijë tarifat ditë-natë për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike në rastet kur ka matës adekuat për këtë qëllim dhe në rastet kur kjo justifikohet nga profili i ngarkesës.
- 7 Tarifa me pakicë për konsumatorët e shërbimit universal do të ndryshojë për të reflektuar koston stinore të ofrimit të shërbimit, për të nxitur konsumin efikas të energjisë elektrike.
- 8 Tarifa e rregulluar me pakicë do të reflektojë koston e furnizimit të kategorive të ndryshme të konsumatorëve, në mënyrë që:
 - 8.1 Të ruajë me saktësi sinjalet e çmimeve të ngarkesave të OT-së, OS-së, TNUOS, DUOS dhe taksës për licencë deri në masën e lejuar nga kufizimet për matjen e konsumatorëve;
 - 8.2 Të mbulojë kostot me pakicë dhe kostot e kapitalit punues që kanë të bëjnë me furnizimin e secilës kategori të ndryshme të konsumatorëve; dhe
 - 8.3 Të reflektojë koston e furnizimit të kategorive të ndryshme të konsumatorëve gjatë stinëve dhe kohëve të ndryshme brenda ditës deri në masën e lejuar nga kufizimet për matjen e konsumatorëve.



KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Gjuha zyrtare e Rregullës

Kjo rregull është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 24

Ndryshimi

- 1 Rregullatori mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
- 2 Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 25

Interpretimi

Në rast paqartësie në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 26

Shfuqizimi

Kjo rregull shfuqizon “Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së)” të aprovuara nga Bordi i Rregullatorit në vitin 2011.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.



SHTOJCA 1 LLOGARITJA E TË HYRAVE TË RREGULLUARA TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

- 1 Kjo shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e të hyrave të rregulluara të shërbimit universal për FSHU-në. Kjo shtojcë plotëson parimet e dhëna në pjesën e parë të Rregullës.
- 2 Të hyrat e rregulluara të shërbimit universal (MAR_t) do të llogariten në bazë të azhurnimeve vjetore me anë të kësaj formule:

$$USRR_t = (RETR_t + WCLC_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t + ADJ_t) / (1 - BDTA_t)$$

Ku:

$USRR_t$ të hyrat e rregulluara të shërbimit universal në vitin relevant T (*“Universal Service Regulated Revenue in relevant year t”*)

$RETR_t$ Kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant t, të cilat caktohen gjatë përshtatjeve vjetore (*“Retail costs in Relevant Year t, which is set at Annual Adjustments”*)

$WCLC_t$ Kostot e lejuara të kapitalit në vitin relevant t (*“Working capital costs in Relevant Year t”*)

$WHPC_t$ Kostot e lejuara të energjisë me shumicë për qullim të ofrimit të shërbimit universal gjatë vitit relevant t (*“Wholesale power costs for the provision of Universal Supply Service in Relevant Year t”*)

$PSTC_t$ Kostot që bartet gjatë vitit relevant t (*“Pass-Through Costs in Relevant Year t”*)

$NTFR_t$ Të hyrat jotarifore në vitin relevant t (*“Non-tariff revenues in Relevant Year t”*)

ADJ_t Përshtatja e të hyrave gjatë vitit relevant t (*“Revenue correction factor in Relevant Year t”*)

$BDTA_t$ Kostot e lejuara për borxhin e keq gjatë vitit relevant t, që caktohen si vlerë përqindjeje (%) (*“Bad Debt Allowance in Relevant Year t, set as a percentage (%) value”*)

- 2.1 Kostot e lejuara të kapitalit punues ($WCLC_t$) do të llogariten sipas formulës:

$$WCLC_t = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$$

Ku:

I_t paraqet normën e interesit në vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku 5 paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori gjatë përshtatjeve vjetore dhe që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huat afatshkurtra;



$RETR_t$ Kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant t ("Allowed Retail Costs in Relevant Year t")

$WHPC_t$ Kostot e energjisë së përgjithshme me shumicë në vitin relevant t ("Allowed wholesale power costs in Relevant Year t")

$PSTC_t$ Kostot që barten në vitin relevant t ("Pass-Through Costs in Relevant Year t")

$NTFR_t$ Të hyrat jotarifore në vitin relevant t ("Non-tariff revenues in Relevant Year t")

2.2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë ($WHPC_t$) duhet të llogariten sipas formulës:

$$WHPC_t = (GENC_t + IMPC_t - EXPR_t * EXPF_t + IMBC_t * IMBF_t) * (1 + RETM_t)$$

Ku:

$GENC_t$ Kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendorë në vitin relevant t ("Allowed costs of purchases from domestic generation in Relevant Year t")

$IMPC_t$ Kostot e lejuara të energjisë së importit në vitin relevant t ("Allowed energy import costs in Relevant Year t")

$IMBC_t$ Kostot neto të imbalancit në vitin relevant t ("Allowed net imbalance costs in Relevant Year t")

$IMBF_t$ Faktori ndarës i imbalancit në vitin relevant t ("Imbalance Sharing Factor in Relevant Year t")

$RETM_t$ Marzha me pakicë në vitin relevant t ("Retail Margin in Relevant Year t")

2.3 Faktori i përshtatjes së të hyrave ($KREV_t$) do të llogaritet duke përdorur formulën në vijim:

$$ADJ_t = (AAC_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku:

ACC_{t-1} Kostot e lejuara aktuale të USS-së në vitin relevant t ("Allowed actual USS costs in Relevant Year t")

ARR_{t-1} Të hyrat aktuale të rregulluara gjatë vitit relevant t-1 ("Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")



I_t *Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori gjatë përshtatjeve vjetore që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtra*



SHTOJCA 2 PROCESI I SHQYRTIMIT TË VLERAVE HYRËSE

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, rregullatori do të publikojë në faqen elektronike zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet e tjera relevante të pranuar nga FSHU apo palët e tjera të interesit që kanë të bëjnë me shqyrtimin e vlerave hyrëse brenda një afati të arsyeshëm, pas pranimit të informatave të dorëzuara nga FSHU, duke mos përfshirë këtu informatat që Rregullatori i konsideron komercialisht konfidenciale.
- 2 Rregullatori mund të iniciojë shqyrtimin e vlerave hyrëse kurdo që i duket e arsyeshme. Nëse iniciohet shqyrtimi i vlerave hyrëse ai duhet të fillojë jo më vonë se 120 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. Një orar tjetër do të aplikohet gjatë periudhës kalimtare, siç specifikohet në Shtojcën 8.
- 3 Orari për procesin e përgjithshëm të shqyrtimit do të dërgohet te FSHU-ja gjatë inicimit të procesit të shqyrtimit.
- 4 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin e vlerave hyrëse duke njoftuar FSHU-në lidhur me:
 - 4.1 Vitet për të cilat kërkohen të dhënat për vitin aktual dhe parashikimet për të ardhmen;
 - 4.2 Formatin me anë të të cilit këto të dhëna do të dorëzohen;
 - 4.3 Orarin për dorëzimin e propozimit të FSHU-së për shqyrtimin e vlerave hyrëse.
- 5 Propozimi i FSHU-së do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
 - 5.1 Të hyrat e realizuara të rregulluara që janë fituar nga tarifa e me pakicë për konsumatorët e shërbimeve universale gjatë vitit relevant (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
 - 5.2 Koston e realizuar për ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar gjatë vitit relevant, në linjë me përkufizimin e kostos që është përdorur për llogaritjen e të hyrave të rregulluara të shërbimit universale;
 - 5.3 Raportin vjetor dhe pasqyrat financiare të audituara për secilin vit fiskal që ka përfunduar në vitin relevant aktual, kur këto janë në dispozicion sipas kriterëve për raportim të cilat i përmban licenca e FSHU-së;
 - 5.4 Sasinë e konsumit të energjisë elektrike të realizuar gjatë periudhës më të vonshme 12- mujore;
 - 5.5 Parashikimin e konsumit të energjisë elektrike për vitin relevant;
 - 5.6 Numrin e konsumatorëve të rregulluar dhe të parregulluar për vitin e tanishëm relevant;



- 5.7 Numrin e parashikuar të konsumatorëve të rregulluar dhe të parregulluar për vitin e ardhshëm relevant;
 - 5.8 Të hyrat e rregulluara të shërbimeve universale të parashikuara, duke raportuar ndaras për secilën prej komponentëve të kostos së lejuar, për vitin e ardhshëm relevant;
 - 5.9 Përcaktuesit aktualë të faturimit për periudhën më të vonshme 12-mujore si dhe përcaktuesit e parashikuar të faturimit për vitin e ardhshëm relevant, bazuar në parashikimet lidhur me kërkesën, energjinë dhe numrin e konsumatorëve për secilën kategori të tyre;
 - 5.10 Vlerat hyrëse të propozuara për vitin e ardhshëm relevant;
 - 5.11 Çdo studim të realizuar nga FSHU-ja që ka të bëjë me ndonjërin prej çështjeve të ngritura në propozimin e FSHU-së; dhe
 - 5.12 Çdo material tjetër shtesë që rregullatori konsideron se duhet të përfshihet në propozimin e FSHU-së, për sa kohë që rregullatori ta njoftojë FSHU-në me një kohë të arsyeshme para kalimit të afatit për dorëzimin e propozimit të FSHU-së.
- 6 Gjatë përgatitjes së propozimit të saj, FSHU do të zbatojë plotësisht parimet e kësaj rregulle. FSHU do të deklarojë të gjitha vendet ku nuk janë zbatuar këto parime, arsyet për moszbatimin e tyre, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit të përdorimit të kësaj qasjeje.
- 7 Pas marrjes së propozimit të FSHU-së, Rregullatori do të vlerësojë saktësinë, lidhshmërinë dhe arsyeshmërinë, duke përfshirë përcaktimin nëse:
- 7.1 Propozimi për vlerat hyrëse reflekton kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar; dhe
 - 7.2 Propozimi për tarifën e rregulluar me pakicë reflekton balancim të drejtë në mes të interesave të FSHU-së dhe atyre të konsumatorëve të rregulluar.
- 8 Rregullatori do të përgatisë një vlerësim të përkohshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce), para fillimit të vitit të ardhshëm relevant pas shqyrtimit të aplikacionit të FSHU-së dhe pas konsultimit me FSHU-në. Vlerësimi i përkohshëm do të paraqesë propozimet e rregullatorit për vlerat hyrëse dhe arsyeshmërinë për këtë propozim. Rregullatori gjatë përgatitjes së vlerësimit të përkohshëm mund të plotësojë-ndryshojë, të ndryshojë apo të fshijë cilëndo pjesë të propozimit të FSHU-së sipas vlerësimit të tij në rastet kur rregullatori ofron arsyeshmërinë për këto plotësim-ndryshime, zhvendosje apo fshirje.



- 9 Pas përcaktimit të vlerësimit të përkohshëm, rregullatori do të njoftojë FSHU-në dhe do të fillojë procesin e konsultimit publik mbi vlerësimin e përkohshëm në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 10 Pas përfundimit të konsultimit publik, brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce), para fillimit të vitit të ardhshëm relevant, rregullatori do të marrë vendim për vlerat hyrëse. Ky vendim do të jenë në pajtueshmëri me këtë rregull. Orari alternativ do të aplikohet gjatë periudhës kalimtare siç jepet në Shtojcën 8.
- 11 FSHU mund të apelojë apo kontestojë vendimin e Rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



SHTOJCA 3 PROCESI I PËRSHTATJEVE VJETORE

- 1 Procesi i përshtatjeve vjetore për FSHU-në do të përbëhet nga tri faza:
 - 1.1 Faza 1: Përcaktimi i kostove të blerjes së energjisë me shumicë.
 - 1.2 Faza 2: Përcaktimi i kostove me pakicë.
 - 1.3 Faza 3: Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale dhe tarifës së rregulluar me pakicë.

- 2 **Faza 1: Përcaktimi i kostove të blerjes së energjisë me shumicë**
 - 2.1 FSHU do të dorëzojë propozimin për kostot e blerjes së energjisë me shumicë që do të përfshihet në llogaritjen e të hyrave të rregulluara për vitin e ardhshëm relevant, së paku 80 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. FSHU do të përfshijë po ashtu të gjitha të dhënat dhe dëshmitë relevante.
 - 2.2 Rregullatori do ta njoftojë FSHU-në së paku 60 ditë pune para fillimit të Vitit të ardhshëm relevant, nëse i aprovon ose jo, kostot e blerjes së energjisë me shumicë të propozuara nga FSHU-ja.
 - 2.3 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për kostot e blerjes së energjisë me shumicë, atëherë rregullatori duhet të ofrojë një vlerë alternative për kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e kostove të energjisë për vitin e ardhshëm relevant. Arsyetimi dhe dëshmitë për vlerën alternative do të sigurohen në pajtim me këtë rregull.

- 3 **Faza 2: Përcaktimi i kostove me pakicë**
 - 3.1 FSHU do të dorëzojë propozimin për kostot me pakicë që duhet të përfshihen në llogaritjen e të hyrave të rregulluara të shërbimit universal për vitin e ardhshëm relevant së paku 50 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. FSHU duhet të përfshijë po ashtu të gjitha të dhënat dhe dëshmitë përkatëse.
 - 3.2 Rregullatori do ta njoftojë FSHU-në së paku 40 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant, nëse i aprovon ose jo, kostot me pakicë të propozuara nga FSHU-ja.
 - 3.3 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për kostot me pakicë, atëherë rregullatori duhet të ofrojë një vlerë alternative për kostot me pakicë që duhet të përfshihen në llogaritjen e të hyrave të rregulluara të shërbimit universal për vitin e ardhshëm relevant. Arsyetimi dhe dëshmitë për vlerën alternative do të sigurohen në pajtim me këtë rregull.

- 4 **Faza 3: Përcaktimi i të hyrave të rregulluara të shërbimit universal dhe tarifës së rregulluar me pakicë**



- 4.1 FSHU do të dorëzojë te rregullatori propozimin për të hyrat e rregulluara të shërbimit universal dhe përshtatjen e nevojshme për tarifën e rregulluar me pakicë për vitin e ardhshëm relevant së paku 20 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. FSHU po ashtu do të përfshijë në këtë dorëzim edhe dokumentet relevante dhe evidencën, përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me të gjithë komponentët e formulave të azhurnimit vjetor të dhëna në Shtojcën 1 si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga rregullatori.
- 4.2 Rregullatori në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë nga FSHU që të japë sqarime shtesë për metodën e tij të llogaritjes së propozimit për të hyrave të rregulluara të shërbimit universal apo të tarifës së rregulluar me pakicë dhe, nëse kjo kërkohet, FSHU duhet të ofrojë, brenda një periudhe të shpejtë kohore, çdo informatë apo shpjegim të mëtejshëm që kërkohet nga rregullatori.
- 4.3 Rregullatori do ta informojë FSHU-në para fillimit të vitit të ardhshëm relevant nëse e aprovon llogaritjen e FSHU-së për të hyrave të rregulluara të shërbimit universal dhe për tarifën e rregulluar me pakicë.
- 4.4 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për të hyrave të rregulluara të shërbimit universal dhe tarifën e rregulluar me pakicë, atëherë këto do të jenë të hyrave të rregulluara të shërbimit universal dhe tarifa e rregulluar me pakicë për vitin e ardhshëm relevant.
- 4.5 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për të hyrave të rregulluara të shërbimit universal dhe tarifën e rregulluar me pakicë, rregullatori do të japë arsyetim dhe evidencë për këtë, në pajtim me këtë rregull. Tarifa e rregulluar me pakicë nuk do të ndryshojë derisa rregullatori të aprovojë një propozim alternativ ose të japë llogaritjen e tij për të hyrave të rregulluara të shërbimit universal dhe përshtatjen përkatëse të tarifës së rregulluar me pakicë.
- 4.6 Çdo ndryshim në të hyra që mund të rezultojë nga llogaritjet e gabuara, raportimi i gabuar i të hyrave të realizuara të rregulluara apo kontestimet lidhur me azhurnimet vjetore, do të mbulohen në vitet relevante pasuese.
- 4.7 FSHU-ja mund të apelojë apo kontestojë çdo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



SHTOJCA 4 PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

- 1 Nëse ka ndodhur një ngjarje e jashtëzakonshme, FSHU-ja mund të kërkojë shqyrtim të jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda tre muajsh të shqyrtimit të vlerave hyrëse apo përfundimit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm të mëhershëm.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një ngjarje të jashtëzakonshme. Në këto raste, kjo shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre ngjarjeve.
- 4 Brenda 20 ditëve të punës pas kërkesës së FSHU-së për shqyrtim të jashtëzakonshëm, FSHU duhet të dorëzojë raportin për ndikimin financiar që do të përfshijë çështjet në vijim:
 - 4.1 Përshkrimin e ngjarjes së jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm;
 - 4.2 Përmbledhjen e ndikimit të ngjarjes së jashtëzakonshme në veprimtarinë e FSHU-së;
 - 4.3 Vlerësimin e ndryshimeve në kostot e FSHU-së të ofrimit të shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar në secilin vit nga data kur ka ndodhur (apo filluar) ngjarja e jashtëzakonshme deri në përfundimin e vitit aktual relevant;
 - 4.4 Vlerësimin e ndryshimeve në të hyrat e parashikuara nga tarifa e rregulluar me pakicë që rezultojnë nga ngjarja e jashtëzakonshme në secilin vit nga data kur ka ndodhur (apo filluar) ngjarja e jashtëzakonshme deri në përfundimin e vitit aktual relevant;
 - 4.5 Llogaritjen e ndikimit financiar nga ngjarja e jashtëzakonshme në FSHU, e llogaritur si shuma e ndryshimeve në kostot dhe të hyrat e mësipërme të FSHU-së. Të hyrat do të trajtohen si numra pozitivë dhe kostot do të trajtohen si numra negativë; dhe
 - 4.6 Llogaritjen në lidhje me atë nëse ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se pragu i materialitetit, shumëzuar me të Hyrat që FSHU ka marrë (në vitin para ngjarjes së jashtëzakonshme), shumëzuar me përqindjen e vitit relevant që mbetet në mes të datës së ngjarjes së jashtëzakonshme dhe përfundimit të vitit relevant.
- 5 Nëse FSHU përcakton se ndikimi financiar është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të përfshijë në raportin e saj të ndikimit financiar propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme të të hyrave të rregulluara të shërbimit universal dhe tarifës së rregulluar me pakicë. Propozimi për përshtatjen e jashtëzakonshme duhet të pëmbushë këto kushte:



- 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë të hyrat e rregulluara të shërbimit universal dhe tarifën e rregulluar me pakicë, në atë mënyrë që ndryshimi i parashikuar të jetë i barabartë me ndikimin financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme;



- 5.2 Tarifa e re e rregulluar me pakicë duhet të jetë në përputhje me metodologjinë për strukturën tarifore dhe, kurdo që është e mundur, të jetë në përputhje me strukturën tarifore që ka ekzistuar para ndodhjes së ngjarjes së jashtëzakonshme; dhe
 - 5.3 Kohëzgjatja dhe struktura e përshtatjes së jashtëzakonshme, ku është e mundur, duhet të reduktojnë rritjet e menjëhershme të tarifave për kategoritë e konsumatorëve (për shembull duke zbutur efektin e përshtatjes së jashtëzakonshme përgjatë disa vitesh).
- 6 Rregullatori mund gjithashtu të fillojë shqyrtimin e jashtëzakonshëm pa kërkesën e FSHU-së. Në këto raste, rregullatori do ta njoftojë FSHU-në dhe do të përfshijë një përshkrim të ngjarjes së jashtëzakonshme si dhe një përmbledhje të ndikimit të saj të pritshëm. Pastaj, FSHU do të përgatisë raportin e ndikimit financiar sipas procesit të përshkruar më lart.
 - 7 Rregullatori mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme sqarime shtesë për mënyrën e tij të llogaritjes së raportit të ndikimit financiar si dhe përshtatjes së jashtëzakonshme dhe, nëse kërkohet kjo, FSHU duhet t'i dërgojë rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat apo shpjegimet e mëtejshme të kërkuara.
 - 8 Brenda 20 ditëve të punës pas marrjes së raportit për ndikimin financiar, rregullatori do ta njoftojë FSHU-në nëse rregullatori e pranon apo jo propozimin e FSHU-së për përshtatjen e jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse:
 - 1.1 I plotëson kushtet e përshkruara më lart;
 - 1.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
 - 1.3 Merr parasysh të gjitha informatat materiale në dispozicion gjatë asaj kohe.
 - 2 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, Tarifa e re e rregulluar me pakicë do të hyjë në fuqi menjëherë.
 - 3 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, rregullatori duhet të ofrojë arsyeshmërinë dhe evidencën për këtë, në pajtim me këtë rregull. Tarifa e rregulluar me pakicë nuk do të përshtatet derisa rregullatori do ta aprovojë një propozim.
 - 4 FSHU mund të apelojë apo kontestojë çdo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.



SHTOJCA 5 NGJARJET E JASHTËZAKONSHME

- 1 Ngjarje e jashtëzakonshme do të konsiderohet të jetë:
 - 1.1 Ndryshimi në shkallën tatimore të aplikueshme për FSHU-në që nuk do të mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve vjetore;
 - 1.2 Çfarëdo ngjarje e forcës madhore (force majeure), e përkufizuar në Shtojcën 7;
 - 1.3 Çfarëdo ngjarje tjetër që përmbush të gjitha kushtet në vijim:
 - (i) Nuk ka qenë nën kontrollin e FSHU-së;
 - (ii) Nuk do të mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve vjetore; dhe
 - (iii) Do t'i ndryshojë në masë të konsiderueshme të hyrat dhe/ose kostot e FSHU-së gjatë një periudhe 12-mujore, në atë masë që mund të vlerësohet e arsyeshme se mund të tejkalohet pragu i materialitetit (e sqaruar në Shtojcën 5).
- 2 Ndodhja e ngjarjes së jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të shkaktuar shqyrtimin e jashtëzakonshëm por, siç sqarohet në Shtojcën 5, ajo ngjarje duhet ta tejkalojë pragun e materialitetit në mënyrë që të përshtaten të hyrat e rregulluara të shërbimit universal dhe tarifa e rregulluar me pakicë.



SHTOJCA 6 NGJARJET E FORCËS MADHORE

Forcë madhore - është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Krenar Bujupi, U.D Kryesues

Arsim Janova, Anëtar

Besim Sejfiqaj, Anëtar